LIGJ
Nr. 10 192, datë 3.12.2009
PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT, KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE TË TJERA NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË

(ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017, 34/2019, datë 17.6.2019, nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti
(shtuar fjalë me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin dhe korrupsionin, si dhe në kryerjen e krimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 2
Qëllimi
(shtuar fjalë me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit dhe krimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustifikuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.

Neni 3
Fusha e zbatimit
(shtuar shkronja "d" në paragrafin e parë me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014 dhe ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:

a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;

b) pjesëmarrje dhe kryerje e krimeve nga organizata terroriste dhe krimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;

c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal;

ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;

d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta;

b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

3. Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.

4. Të dhënat e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.

5. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

6. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.

Neni 4

Masa parandaluese

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

Në kuptim të këtij ligji, "Masë parandaluese" është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre.

Neni 5

Marrëdhënia me procedimin penal

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.

2. Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj.

3. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.

Neni 6

Objekti i hetimeve

(ndryshuar titulli, pika 1 dhe shtuar pika me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Prokurori ndërmerr, edhe nëpërmjet policisë gjyqësore, hetimet e nevojshme ndaj personave të përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik dhe burimet e të ardhurave të tyre, si dhe pyetjen e personave që kanë dijeni mbi faktet objekt i këtij ligji dhe kryerjen e ekspertimeve të nevojshme. Kur lind nevoja për ndihmë juridike ndërkombëtare, zbatohen marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe dispozitat përkatëse procedurale.

2. Verifikimet bëhen, në veçanti, nëse këta persona janë zotërues të lejeve, licencave, autorizimeve, koncesioneve dhe të drejtave të tjera për të ushtruar veprimtari ekonomike, tregtare dhe profesionale, si dhe për të verifikuar nëse ata përfitojnë kontribute, financime ose kreditime të çdo lloji, të dhëna apo të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare, si dhe për të verifikuar nëse pasuritë, veprimtaritë apo të drejtat pasurore janë të përligjura.

3. Hetimet e përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të urdhërohen nga prokurori deri në përfundim të seancës për konfiskim.

Neni 7

Kompetenca dhe përbërja e gjykatës

(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykatat e rretheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

2. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese shqyrtohet në shkallë të dytë, nga gjykatat e apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas rregullit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, dispozitat e paragrafit 1, të nenit 80, të Kodit të Procedurës Penale.

4. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë me një gjyqtar. Ankimi kundër vendimit për marrjen e masës parandaluese shqyrtohet nga gjykatat e apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Neni 8

Verifikimet paraprake

(ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Prokuroria dhe policia gjyqësore marrin dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, me iniciativën e vet ose me njoftim të bërë nga të tretët.

2. Me marrjen dijeni për pasuritë, që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, policia gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe të dhënat e siguruara prej saj.

3. Prokurori kryen veprime vetë dhe nëpërmjet Policisë Gjyqësore për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, mënyrës së jetesës, si dhe të burimeve të të ardhurave të personave, subjekte të zbatimit të këtij ligji.

Neni 9
Detyrimi i dorëzimit të informacionit dhe të dokumenteve

1. Prokurori, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Policisë Gjyqësore, mund të kërkojë pranë çdo zyre të administratës shtetërore, enti a personi juridik publik, personave të tjerë fizikë dhe juridikë, të dhëna dhe kopje të dokumenteve, që vlerësohen si të domosdoshme për qëllime verifikimi ndaj pasurive të personave të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji.

2. Me autorizim të lëshuar nga prokurori ose gjykata, oficerët e Policisë Gjyqësore mund të vendosin sekuestrimin e dokumenteve të shqyrtuara, sipas rregullave të parashikuara në nenet 208, 209, 210 dhe 211 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 10
Kompetencat e gjykatës
(ndryshuar titulli dhe pika 1 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Gjykata, me kërkesë të prokurorit, të palëve ose kryesisht urdhëron hetimet e nevojshme për të zgjidhur çështjen dhe mund të miratojë masat e përcaktuara me ligje të veçanta.

2. Nëse gjatë gjykimit lind nevoja për ndihmë juridike ndërkombëtare, zbatohen marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuara nga shteti shqiptar, si dhe dispozitat respektive procedurale.

KREU II
SEKUESTRIMI I PASURISË

Neni 11
Kriteret për sekuestrim të pasurisë
(ndryshuar pjesa hyrëse e pikës 1 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësi të plotë ose të pjesshme të personave, sipas nenit 3, pika 1, të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura shpërpjesëtimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përligjen prej tyre, si dhe kur:

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

2. Kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë përmban indiciet, në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm, si dhe arsyetimin për të paktën një prej kushteve të pikës 1 të këtij neni.

Neni 12
Procedura e sekuestrimit
(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata në dhomën e këshillimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori.

2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.

3. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të prokurorit ose kryesisht, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha gjashtëmujore, por jo më shumë se dy vjet nga data e fillimit të afatit të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit, e cila vendos brenda 15 ditëve nga marrja e akteve.

4. Jo më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit, të parashikuar në pikën 2 ose 3, të këtij neni, gjykata cakton një seancë të posaçme, duke njoftuar prokurorin, personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, si dhe mbrojtësin e zgjedhur. Kërkesa e prokurorit për revokimin e sekuestrimit nuk e pengon gjykatën të vendosë konfiskimin e pasurisë kur ajo çmon se plotësohen kriteret e parashikuara në këtë ligj.

5. Kur seanca e posaçme, sipas pikës 4, të këtij neni, nuk caktohet, gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, konstaton shuarjen e masës së sekuestrimit. Shuarja e masës së sekuestrimit nuk pengon paraqitjen dhe pranimin e një kërkese të re për konfiskimin e pasurisë.

Neni 12/a

Sekuestrimi ose konfiskimi i pasurisë së barasvlershme

(shtuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Sekuestrimi ose konfiskimi vendoset mbi mjete monetare ose mbi çdo pasuri tjetër në zotërim të personave të përmendur në nenin 3, të këtij ligji, kur, pas marrjes në dijeni për hetimet në ngarkim të tij, personi, kundër të cilit kërkohet të vendoset masa tjetërson, shpërndan, transferon, shpërdoron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë, me qëllimin për të shmangur ekzekutimin e masës së sekuestrimit ose konfiskimit të saj.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kur personi i tretë është në keqbesim, pasuria sekuestrohet ose konfiskohet.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen, deri në masën e vlerës së pasurisë, për të cilën është vendosur sekuestrimi ose konfiskimi, edhe kur del që ajo është bashkuar me pasuri të tjera.

4. Rregullat e pikave të mësipërme të këtij neni zbatohen edhe kur pasuria e paligjshme është trupëzuar me pasuri të ligjshme dhe nuk mund të ndahet prej saj pa i shkaktuar një dëm thelbësor.

Neni 12/b

Revokimi i sekuestrimit

(shtuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Gjykata, me kërkesë të palëve, vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë edhe përpara afatit të parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 12, të këtij ligji.

2. Gjykata vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë, duke e zëvendësuar atë me pasuri të barasvlershme, kur palët japin pëlqimin dhe gjykata e çmon të përshtatshme.

Neni 13

Vendimi i gjykatës kur revokohet masa e sekuestrimit

(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, hequr fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Vendimi i gjykatës që vendos revokimin e sekuestrimit, sipas nenit 12/b, të këtij ligji, i përcillet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e cila njofton pronarin e pasurive të sekuestruara.

2. Dorëzimi i pasurive te pronari bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që administratori i pasurive ia dorëzon pronarit.

3. Kur brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për revokimin e sekuestrimit, pronari i pasurisë nuk paraqitet, pa shkaqe te arsyeshme, për t'i marrë në dorëzim ato, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara çlirohen nga çdo përgjegjësi.

4. Revokimi i masës së sekuestrimit nuk pengon përdorimin për qëllime tatimore të të dhënave dhe provave të siguruara gjatë hetimit.

5. Me vendimin e revokimit të sekuestrimit, gjykata mund të vendosë detyrimin ndaj pronarit të pasurisë apo personit që ka në përdorim ose administrim pasurinë, apo pjesë të saj, për të njoftuar administratën tatimore, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e njoftimit të vendimit, për akte të zotërimit, blerjes ose pagesave të kryera, të pagesave të marra, detyrave profesionale të administrimit ose kujdestarisë, si dhe për akte apo kontrata të tjera, sipas llojit dhe vlerës së përcaktuar nga gjykata, në varësi të pasurisë dhe të të ardhurave të personit, në çdo rast, për një vlerë jo më të vogël se 2 milionë lekë.

6. Njoftimet e parashikuara në pikën 5, të këtij neni, kryhen brenda 10 ditëve nga kryerja e aktit, kurse për aktet e kryera në vitin pararendës, brenda datës 31 janar të çdo viti.

7. Personit që nuk respekton detyrimet e njoftimit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6, të këtij neni, pa paraqitur shkaqe të arsyeshme, i konfiskohen, tërësisht ose pjesërisht, sendet e fituara dhe pagesat e marra, për të cilat nuk është respektuar detyrimi i njoftimit.

Neni 14

Ekzekutimi i masës së sekuestrimit

(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, zëvendësuar fjalë në pikat 3, 5, 8 dhe 9 me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Vendimi i sekuestrimit zbatohet menjëherë. Sekretaria e gjykatës i dërgon, pa vonesë, dy kopje të vendimit prokurorit që ka paraqitur kërkesën. Prokurori merr masa për vënien në ekzekutim të vendimit nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore dhe administratorit të pasurive.

2. Sekuestrimi ekzekutohet:

a) për pasuritë e luajtshme dhe shumat monetare, sipas rregullave të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile, në rastet e rizotërimit të aseteve nga debitori ose nga pala e tretë;

b) për pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme në zyrat kompetente për regjistrimin e tyre;

c) për pasuritë e shoqërive tregtare, përveç mënyrës të parashikuar nga ky ligj për çdo pasuri tjetër të sekuestruar, edhe me anën e regjistrimit të vendimit në regjistrin e shoqërive tregtare;

ç) për kuotat dhe aksionet, me anën e publikimit në regjistrin e shoqërive tregtare dhe shënimin në regjistrat kontabël të shoqërisë.

3. Policia gjyqësore, pas urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori, procedon me marrjen e pasurisë dhe dorëzimin tek Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara edhe kur personat që preken nga masa kanë të drejta reale ose personale për t'i gëzuar ato.

4. Policia gjyqësore u njofton masën e sekuestrimit të pasurive personave të përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji. Policia gjyqësore u njofton, gjithashtu, personave të mësipërm, edhe vendimin e gjykatës për shtyrjen e afatit të sekuestrimit.

5. Kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurisë së paluajtshme ose pasurisë së regjistruar në regjistra publikë, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara njofton menjëherë këtë masë në zyrat pranë të cilave mbahen këta regjistra.

6. Kur sendi mbahet pa titull pronësie ose në bazë të një titulli që daton përpara datës së vendimit të sekuestrimit dhe poseduesi i sendit nuk pranon ta dorëzojë atë vullnetarisht, gjykata urdhëron lirimin e sendit. Urdhri i gjykatës ekzekutohet nga policia gjyqësore.

7. Inventari dhe përshkrimi i pasurisë së sekuestruar bëhen nga policia gjyqësore dhe dokumentohen në një raport, i cili nënshkruhet nga të pranishmit. Ky raport përmban elementet e parashikuara nga neni 524 i Kodit të Procedurës Civile.

8. Gjatë marrjes në dorëzim të pasurisë së sekuestruar nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, policia gjyqësore u dorëzon një kopje të raportit të

përmendur në pikën 7, të këtij neni, personave të pranishëm në kohën e inventarit.

9. Policia gjyqësore dorëzon pasurinë e sekuestruar tek Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor dhe, nëse ka, edhe me regjistrat e llogarive të shoqërisë tregtare.

10. Administratori i pasurisë, për qëllime të administrimit dhe në mungesë të dokumentacionit të parashikuar në pikën 9, të këtij neni, vë në dispozicion të audituesit ligjor, të caktuar nga agjencia për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, të dhënat e nevojshme për administrimin e pasurisë, duke i kërkuar hartimin e një raporti. raporti vihet në dispozicion të Agjencisë.

KREU III
ADMINISTRIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR

Neni 15
Administratori i pasurisë së sekuestruar
(hequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017 dhe ndryshuar me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Gjykata në vendimin e sekuestrimit të pasurisë cakton Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si administratore të këtyre pasurive. Agjencia vë në dispozicion të gjykatës listën e administratorëve të punësuar pranë saj të paktën 1 (një) herë në vit dhe tregon kriteret e caktimit të tyre.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara mund të kërkojë ndihmën e ekspertëve ose të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë.

Neni 16
Detyrat e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
(shfuqizuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar titulli i nenit, fjalë në pikat 1 dhe 2 dhe pika 3 me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu, ajo ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për ekzekutimin e masës së sekuestrimit dhe për administrimin e sendit, paraqet çdo kërkesë të nevojshme pranë prokurorisë, apo çdo institucioni tjetër shtetëror.

3. Gjykata ose prokurori mund t'i kërkojë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në çdo kohë informacion për mënyrën e administrimit të pasurisë. Ky informacion jepet nga Agjencia brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.

Neni 17
Ndalime për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
(ndryshuar fjalë në paragrafin e parë dhe shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar titulli i nenit, fjalë në paragrafët e parë dhe të dytë dhe paragrafi i tretë me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

Përveç rasteve kur autorizohet paraprakisht Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk lejohet të marrë pjesë në gjykim, të marrë kredi, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi ose tjetërsimi të pasurisë së sekuestruar, apo të kryejë

veprime të tjera juridike përtej veprimeve të administrimit të zakonshëm.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara i paraqet Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar kërkesë të argumentuar kur çmon se duhet të kryhen veprimet juridike të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar shprehet me vendim nëse e miraton ose e rrëzon kërkesën e Agjencisë.

Neni 18

Raportimet e Agjencisë

(shtuar pika 4 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar titulli i nenit, fjalë në pikat 1 dhe 2 dhe 3 me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Brenda 15 ditëve nga ngarkimi me administrimin e pasurisë, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara detyrohet t'i paraqesë gjykatës një raport të hollësishëm për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes, në të cilën ndodhet pasuria e sekuestruar. Në vijim, me kërkesë të gjykatës, Agjencia i paraqet asaj raporte periodike për administrimin e pasurisë së sekuestruar, të shoqëruara, nëse kërkohet, me dokumentacionin përkatës.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është e detyruar të njoftojë gjykatën edhe për pasuri të tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestrimit, për ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit.

3. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara detyrohet që raportet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni t'ia dërgojë njëkohësisht edhe prokurorit.

4. Gjykata thërret kryesisht Kryeadministratorin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për të marrë informacion për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe për çdo të dhënë tjetër që e konsideron të dobishme për vendimin e konfiskimit. Kryeadministratori i Agjencisë mund të delegojë një nëpunës në varësi të tij për t'u paraqitur përpara gjykatës.

Neni 19

Kalimi i të drejtave reale për pasuritë e sekuestruara

(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Për pasuritë, të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit, me kërkesë të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar vendos kalimin e të drejtave reale tek të tretët, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë. Të drejtat reale nuk kalohen te personat e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji. Komiteti vendos pasi dëgjon palët dhe ekspertin vlerësues.

2. Gjykata kur vendos revokimin e sekuestrimit, urdhëron kthimin e pasurisë së sekuestruar, ose kundërvlerën e saj pronarit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 20

Përballimi i shpenzimeve të administrimit

(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar fjalë me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Shpenzimet e nevojshme ose të dobishme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruar përballohen nga fondet e siguruara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga çdo burim i ligjshëm.

2. Nëse nëpërmjet administrimit të pasurisë së sekuestruar nuk përfitohen fonde të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve, sipas pikës 1, të këtij neni, ato parapaguhen nga

shteti nëpërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me të drejtën e kthimit të tyre nga personi, të cilit i sekuestrohet pasuria, edhe në rastin e revokimit të sekuestrimit ose të konfiskimit[*].

3. Në rastet e vendosjes së masës së konfiskimit të pasurisë, shpenzimet e përballuara për administrimin e kësaj pasurie nga administratori ose Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshihen në llogaritë e administrimit të tyre. Nëse fondet e llogarive të administrimit nuk janë të mjaftueshme për të përballuar pagesën e këtyre shpenzimeve, ato paguhen pjesërisht ose plotësisht nga shteti, pa të drejtë kompensimi.

3/1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk është përgjegjëse për pagimin e detyrimeve të subjekteve të përmendura në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, të maturuara përpara vendimit të sekuestrimit, lidhur me:

a) shpenzimet e mirëmbajtjes dhe administrimit të zakonshëm të pasurisë;

b) pagesat e prapambetura të energjisë elektrike, ujit, telefonisë etj.; si dhe

c) taksat ose detyrimet tatimore të prapambetura.

4. Kur gjykata vendos revokimin e masës së sekuestrimit, zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë frytet e pasurisë, të realizuara gjatë administrimit. Ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin në masën e pakësimit të vlerës së pasurisë ose të dëmit që i është shkaktuar asaj.

KREU IV
KONFISKIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR

Neni 21
Kërkesa për konfiskimin e pasurisë dhe barra e provës

(ndryshuar pika 1, 3 dhe shtuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Konfiskimi i pasurisë vendoset me kërkesë të prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa. Gjykata vendos pas kryerjes së hetimit gjyqësor dhe pasi dëgjon diskutimin përfundimtar të palëve.

Gjykata mund të vendosë konfiskimin edhe në përfundim të seancës së posaçme, të parashikuar në nenin 12, pika 4, të këtij ligji.

2. Konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe në raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit.

3. Personat e përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji, kanë barrën për të provuar se veprimtaritë dhe pasuritë e sekuestruara, të zotëruara pjesërisht ose plotësisht prej tyre janë fituar nga burime të ligjshme.

4. Personat e përmendur në nenin 3, pika 2, shkronja "a", të këtij ligji, kanë barrën për të provuar që pasuritë, për të cilat kërkohet konfiskimi, zotërohen me titull pronësie vetëm prej tyre, janë përfituar nga burime të ligjshme dhe nuk janë në pronësi të tërthortë të personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji.

5. Personat e përmendur në nenin 3, pika 2, shkronja "b", të këtij ligji, kanë barrën për të treguar që të dhënat e siguruara gjatë procedimit pasuror janë të pamjaftueshme për të vërtetuar se veprimtaritë ose pasuritë e tyre:

a) zotërohen tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të tërthortë, nga ana e personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji; ose

b) janë përdorur, kanë lehtësuar ose kanë ndikuar, në një formë të caktuar, në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga ana e personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji.

Neni 22

[*] *Me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020, në pikën 2 hiqen fjalët "…administratori ose…"*

Procedura gjyqësore e konfiskimit
(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

2. Me kërkesë të prokurorit gjykata mund të vazhdojë gjykimin edhe në raste kur personi nuk ka banim të njohur brenda vendit, është larguar jashtë shtetit ose, me gjithë kërkimet e bëra, nuk gjendet. Në këtë rast gjykata vendos mosgjetjen e personit, duke i caktuar atij një mbrojtësi. Mbrojtësi mund të caktohet kryesisht nga gjykata ose të zgjidhet nga të afërmit e personit.

3. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces.

4. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata, ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme. Prokurori kryhen çdo hetim të nevojshëm për verifikimin e këtyre pretendimeve.

5. Kur vërtetohet se pasuria është transferuar ose regjistruar apo janë regjistruar në emër të të tretëve, me veprime juridike fiktive ose të simuluara, gjykata konstaton pavlefshmërinë e tyre. Për këtë qëllim, përderisa nuk provohet e kundërta, prezumohen fiktive ose të simuluara edhe:

a) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull barrësor, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese kundër personave të afërm;

b) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull falas apo dukshëm nën vlerën e tregut, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese.

Neni 23
Kohëzgjatja e gjykimit të kërkesës për konfiskim
(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për konfiskim nga prokurori ose nga fillimi i seancës së posaçme, sipas nenit 12, pika 4, të këtij ligji, gjykata vendos për konfiskimin.

2. Në raste komplekse, gjykata, edhe kryesisht, mund të vendosë në një afat të mëvonshëm, por në çdo rast brenda një viti nga afati i parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 24
Pranimi i kërkesës për konfiskim
(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurisë kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, për pjesëmarrje të personit në veprimtari kriminale, të parashikuara në nenin 3, pika 1, të këtij ligji;

b) rezulton se pasuria është, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të plotë ose të pjesshëm të personave të përmendur në nenin 3, pika 1, të këtij ligji;

c) nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme apo personat e përmendur në nenin 3, të këtij ligji, nuk arrijnë të përligjin zotërimin e pasurive ose të ardhurave, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre.

2. Në çdo rast, personi nuk mund të përligjë pasurinë, duke deklaruar si burim të saj të ardhura ose riinvestime, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, gjykata vendos pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit të përmendur në pikën 1, të nenit 3, të këtij ligji, pushohet ose ai deklarohet i pafajshëm, me përjashtim të rasteve kur

në vendimin e pushimit ose të pafajësisë deklarohet se:

a) fakti nuk ekziston;

b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

c) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale.

Neni 24/a

Refuzimi i konfiskimit

(shtuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

Kur gjykata nuk vendos konfiskimin e pasurive të sekuestruara, zbatohen dispozitat e nenit 13 të këtij ligji.

Neni 25

Shpenzimet procedurale

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Në shpenzimet procedurale përfshihen shpenzimet e sekuestrimit, të administrimit, të konfiskimit, të mbrojtësit, si dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar sipas ligjit.

2. Shpenzimet për sekuestrimin, sipas këtij ligji, parapaguhen nga shteti dhe paguhen nga personi, ndaj pasurive të të cilit vendoset sekuestrimi i pasurisë.

3. Gjykata, në vendimin përfundimtar të kërkesës për konfiskim, cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti.

4. Shfuqizuar.

5. Për ankesat për shpenzimet procedurale vendos gjykata që ka dhënë vendimin.

KREU V

VENDIMI, ANKIMI DHE EKZEKUTIMI I MASAVE PARANDALUESE

Neni 26

Elementet e vendimit të gjykatës

(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

Vendimi i gjykatës për marrjen e masës parandaluese përmban:

a) gjykatën që ka dhënë vendimin;

b) kohën dhe vendin e shpalljes së vendimit;

c) emrin e prokurorit;

ç) pretendimet përfundimtare dhe kërkesat e palëve;

d) llojin e masës parandaluese dhe kohëzgjatjen e saj, nëse masa është caktuar me afat;

dh) llojin e pasurisë me të gjitha të dhënat, që shërbejnë për identifikimin e saj, përfshirë edhe vendndodhjen, ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë;

e) parashtrimin e përmbledhur të faktit dhe shkakun ligjor të masës parandaluese;

ë) masën e shpenzimeve procedurale, llojin e tyre, si dhe të dhëna për personin, të cilit i ngarkohen ato.

Neni 27

Ankimi

(ndryshuar fjalë dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë, zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit, revokimit apo të shuarjes së masës së sekuestrimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

2. Kundër vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë mund të bëhet ankim në

gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

3. Ankimi, sipas pikës 1 ose 2 të këtij neni, nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.

4. Kur prokurori paraqet ankim kundër revokimit të sekuestrimit ose refuzimit të kërkesës për konfiskim, ekzekutimi i masës së ankimuar pezullohet deri në marrjen e vendimit nga gjykata e apelit.

Neni 28

Ekzekutimi i vendimit të konfiskimit dhe revokimit të sekuestrimit

(ndryshuar pika 4 dhe 6, shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Vendimi i konfiskimit të pasurive vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së tij.

2. Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.

3. Gjatë ekzekutimit të vendimit të konfiskimit, gjykata, që ka dhënë vendimin, mund të nxjerrë, në dhomë këshillimi, urdhra për kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, ku përcakton edhe afatet e mënyrat e kryerjes së veprimeve dhe masat e nevojshme që duhen marrë.

4. Vendimi dhe urdhrat për kryerjen e veprimeve të posaçme i përcillen pa vonesë prokurorit që procedon, i cili mbikëqyr veprimet e ekzekutimit.

5. Shfuqizuar.

6. Policia gjyqësore mban procesverbal për veprimet e ekzekutimit, i cili i dërgohet gjykatës nëpërmjet prokurorit.

KREU VI

PËRDORIMI I PASURIVE TË KONFISKUARA

Neni 29

Kalimi i pasurive të konfiskuara në pronësi të shtetit

(shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Pasuritë e konfiskuara me vendim gjykate, sipas këtij ligji, kalojnë në pronësi të shtetit.

2. Vendimi i formës së prerë për konfiskimin e pasurive i dërgohet menjëherë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Kur vendimi i konfiskimit merr formë të prerë, pasuria kalon në pronësi të shtetit në mënyrë të pakthyeshme.

4. Kur vendimi i formës së prerë që ka vendosur konfiskimin prishet nga gjykata më e lartë dhe pasuria i rikthehet zotëruesit të mëparshëm, me vendim të formës së prerë, ai ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 30

Kompetenca për mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara

(ndryshuar pika 1 dhe ndryshuar fjalë në pikën 2 dhe 3 ndryshuar fjalë me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, bazuar në rekomandimet dhe raportin e vlerësimit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vendos mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara, sipas këtij ligji, në përputhje me nenet 32 e 33 të tij. Vendimi i komitetit i njoftohet ministrit përgjegjës për financat.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, brenda 90 ditëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor të parashikuar në pikën 2 të nenit 29 të këtij ligji, i paraqet Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar raportin e vlerësimit tekniko-

financiar për çdo pasuri të konfiskuar.

3. Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, me vendim, i cili i njoftohet ministrit përgjegjës për financat, përcakton mënyrën dhe kushtet e përdorimit të pasurive të paluajtshme të konfiskuara dhe brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit tekniko-financiar, por jo më vonë se 120 ditë nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor të parashikuar në pikën 2 të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 31

Detyrat e administratorit të pasurive të konfiskuara

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

Administratori i caktuar nga Agjencia, gjatë fazës së sekuestrimit të pasurive, vazhdon ushtrimin e detyrave, në emër dhe për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për aq kohë sa nuk është zëvendësuar prej saj me një person tjetër.

Neni 32

Përdorimi i mjeteve monetare të sendeve të konfiskuara

(ndryshuar titulli, shtruar fjalë në shkronjën "a" dhe ndryshuar shkronja "c" me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar paragrafi i parë, fjalia e dytë e shkronjës "b" dhe shtuar fjalë në shkronjën "c" me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

Administratori i caktuar nga Agjencia kryen veprimet e nevojshme për të dorëzuar në llogaritë e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara fondet në mjete monetare:

a) të konfiskuara, që nuk do të përdoren për administrimin e pasurive të tjera të konfiskuara, ose që nuk do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale të krimit të organizuar dhe trafikimit;

b) të përfituara nga shitja e pasurive të luajtshme, që nuk përdoren në veprimtarinë e personit juridik tregtar dhe të titujve, në vlerën neto, të përfituara nga shitja e pasurive për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit. Nëse procedurat e shitjes nuk janë ekonomike, Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar i propozon ministrit përgjegjës për ekonominë ndjekjen e procedurave ligjore për transferimin e pronësisë pa pagesë ose shkatërrimin e pasurisë së konfiskuar;

c) që përfitohen nga rimarrja e kredive personale. Nëse procedura e rimarrjes së tyre nuk është ekonomike ose kur pas verifikimeve të bëra nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara për aftësinë paguese të debitorit, rezulton se ai nuk ka aftësi paguese, kreditë personale anulohen nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar sipas procedurës së parashikuar në nenin 30 të këtij ligji.

Neni 33

Përdorimi i pasurive të paluajtshme dhe i atyre që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale

(ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, përcakton kriteret, masën dhe mënyrën e përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe të atyre që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, pjesë e fondit të posaçëm, brenda kufijve të destinimit, të vendosura nga legjislacioni në fuqi.

2. Këshilli i Ministrave, në nxjerrjen e këtij vendimi, bazohet në parimet e miradministrimit të pronës, të rritjes së efektivitetit të drejtësisë penale, si dhe të rehabilitimit dhe

zhdëmtimit të drejtë.

Neni 34

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

(shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 34/2019, datë 17.6.2019 dhe ndryshuar fjalë me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)[†]

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

2. Shfuqizuar.

3. Rregullat e hollësishme për kriteret e vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 35

Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar pikat 1 dhe 2, ndryshuar fjalë në pikat 5, ndryshuar fjalia e parë e pikës 7 dhe shtuar pika 8 me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Për mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe për marrjen e vendimeve për destinacionin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara ngrihet dhe funksionon Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar. Ky komitet mblidhet pranë ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

2. Komiteti përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, të propozuar respektivisht nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë, ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë, ministri përgjegjës për çështjet sociale, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Njësia e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Anëtari i propozuar nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike është kryetar i komitetit. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ushtron funksionin e sekretariatit teknik pranë komitetit.

3. Në veprimtaritë e komitetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve publike ose organizatave të tjera, vendase a të huaja, veprimtarë në fusha me interes për zbatimin e këtij ligji.

4. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara i raporton, të paktën një herë në tre muaj, komitetit për veprimtarinë e saj.

5. Komiteti, bazuar në prioritetet e përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji, jep rekomandime që i drejtohen ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike për disponimin efektiv të të ardhurave të krijuara nga Agjencia, përfshirë edhe rekomandimin për pagimin e shpenzimeve operative të agjencisë.

6. Komiteti, të paktën një herë në gjashtë muaj, u kërkon informacion me shkrim institucioneve qendrore, që i kanë në administrim, si dhe të dhëna të hollësishme për gjendjen dhe

[†] Me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020: "*Në pikën 2 të nenit 34 fjalët "nga Këshilli i Ministrave" zëvendësohen me fjalët "me ligj të posaçëm""* (neni 13).

mënyrën e përdorimit të pasurisë së paluajtshme njësive vendore, që i kanë në pronësi pasuritë e paluajtshme të konfiskuara.

7. Komiteti mblidhet sa herë të jetë e nevojshme, me kërkesë të njërit prej anëtarëve ose të Agjencisë, por jo më pak se 1 (një) herë në 3 (tre) muaj. Komiteti miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të tij.

8. Masa dhe mënyrat e shpërblimit të anëtarëve të Komitetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, në përfundim të çdo viti financiar, i paraqet Këshillit të Ministrave raportin për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, sipas këtij ligji.

Neni 37

Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit

(ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar fjalë me ligjin nr. 85/2020, datë 2.7.2020)

1. Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji shërbejnë për ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor. Fondi i posaçëm është një zë më vete në buxhetin e Agjencisë dhe administrohet me vendim nga Komiteti.

2. Ky fond shërben për:

a) përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe të Ministrisë së Drejtësisë;

b) përmirësimin e parandalimit të kryerjes së veprave penale, të hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar ose krimeve të tjera, që sjellin pasuri/produkte kriminale dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

c) dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale.

ç) dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor.

d) për mbulimin e diferencave në vlerë që mund të krijohen nga administrimi i pasurive, të cilat me vendim gjyqësor i kthehen pronarit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

3. Përveç institucioneve qendrore, përfitues të financimit të projekteve për parandalimin e kriminalitetit mund të jenë:

a) njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara;

b) organizatat jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësimit dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, që, në tri vitet e fundit nga paraqitja e kërkesës, zhvillojnë veprimtari të tilla.

4. Kërkesat për financimin e projekteve, sipas këtij neni, verifikimi dhe përgatitja e dokumentacionit për mendim në Komitetin Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të

Organizuar, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre bëhen nga strukturat e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

5. Komiteti, me vendim, përcakton financimin e projektit dhe mënyrat e përdorimit të fondit të vënë në dispozicion të kërkuesit.

6. Deri më 31.12.2020 fondi që shërben për parandalimin e kryerjes së veprave penale, në funksion të veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk mund të jetë më i vogël se 60 (gjashtëdhjetë) për qind e të ardhurave të përgjithshme.

7. Të ardhurat e papërdorura nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit transferohen në vitin buxhetor pasardhës të Agjencisë.

8.Pjesa e fondit, e destinuar sipas pikës 2 të këtij neni, mund të përdoret për shpërblime të funksionarëve të institucioneve përfituese deri në masën 5 (pesë) për qind të tij.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38
Dispozitë kalimtare

Kërkesat për marrjen e masave parandaluese, të paraqitura nga prokurori në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të gjykohen, sipas rregullave të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare
(vendosur me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Ky ligj zbatohet për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Për procedimet pasurore në fazën e hetimit, ky ligj fillon të zbatohet me hyrjen e tij në fuqi.

3. Për pasuritë e vëna para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që kanë lidhje me veprat penale të reja që shtohen në nenin 3, pika 1, të tij, zbatohen parashikimet e pikës 6, të nenit 3, të këtij ligji.

4. Deri në krijimin e gjykatës së kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, çështjet për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë do të gjykohen nga Gjykata për Krimet e Rënda.

5. Me krijimin e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar çështjet në gjykim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë gjykatë dhe në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

6. Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar çështjet në hetim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë prokurori dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 39
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 15 pika 2, 28 pika 4, 33 dhe 34 të këtij ligji.

Neni 40
Shfuqizime

Ligji nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 41
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6362, datë 22.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi